



Drejtuar: Operatorit ekonomik “Kthella” shpk

Adresa: Kompleksi “Kthella” Resort, Rruga “Shën Viçenzo De Paolo”, përballë varrezave të qytetit Rrëshen, Lezhë, Rrëshen.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Sistemimi dhe rehabilitimi i Qendrës së Njesisë Administrative Zall Bastar”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Sistemimi dhe rehabilitimi i Qendrës së Njesisë Administrative Zall Bastar”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-00286-12-19-2018

Fondi limit: 44,162,155 (dyzetë e katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 132, datë 21.12.2017, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”, rialokuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.01.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 51 datë 24.12.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Elda-VI” shpk

NUIS K67106202W

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Inerti” shpk

NUIS J66926804L

Vlera e ofertës = **34,743,888** (tridhjetë e katër milion e shtatëqind e dyzetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Kthella” shpk

NUIS J69303023D

Vlera e ofertës = **35,236,861** (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “B 93 II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk

NUIS L52209050O & NUIS L26310801C & NUIS L52125110A

Vlera e ofertës = **35,450,270** (tridhjetë e pesë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = **36,208,166.80** (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk

NUIS K11507003S & NUIS K17710805A

Vlera e ofertës = **38,828,962** (tridhjetë e tetë milion e tetëqind e njëzetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **40,460,038** (dyzetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Elda-VI” shpk

NUIS K67106202W

- Pas hapjes së ofertave, u konstatua se shoqëria “Elda-VI” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Inerti” shpk

NUIS

J66926804L

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Inerti” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtës 7-10 Ton, përkatësisht me targa AA 864 CJ si dhe AA 845 CZ. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për mjetin me targa AA 864 CJ nuk është paraqitur Akti i Pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.
- Shoqëria “Inerti” shpk nuk ka paraqitur foto për mjetin elektrosaldatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “d”.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur, rezulton se Shoqëria “Inerti” shpk nuk disponon Rul me kompresor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Rrul me kompresor për ngjeshje asfalti”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Inerti” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “B 93 II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk

NUIS L52209050O & NUIS L26310801C & NUIS L52125110A

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 2.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit të

Dokumentave Standarte të Tenderit: “Nëse oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh ekonomik, duhet te dorëzohen...” pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur **marrëveshje të noterizuar** sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht si dhe **prokurë të posacme**.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 2.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Nëse oferta dorëzohet nga një Bashkim Operatorësh ekonomik, duhet te dorëzohen...” pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur **marrëveshje të noterizuar/kontratë** ku të jenë të përcaktuar zërat e punimeve që do të kryejë secili operator ekonomik cka bie në kundërshtim me Kreut VIII Nenit 74 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe **elementet konkrete**, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017)...” pasi nuk është paraqitur një marrëveshje/kontratë bashkëpunimi ku të përcaktohet pjesëmarrja në përqindje dhe rrjedhimisht edhe vlera e xhiros mesatare vjetore të kërkuar për secilin operator ekonomik.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 2.3 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë...” pasi nuk është paraqitur një marrëveshje/kontratë bashkëpunimi ku të përcaktohet pjesëmarrja në përqindje dhe rrjedhimisht edhe vlera e kontratës/punës së ngjashme për secilin operator ekonomik.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës...” pasi nuk është paraqitur një marrëveshje/kontratë bashkimi ku të përcaktohet pjesëmarrja në përqindje dhe rrjedhimisht nuk përcaktohen kategoritë e licensës që duhet të posedojë secili operator ekonomik.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 4 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Një punësim mesatar i të paktën 55 (pesëdhjetë e pesë) personave, për periudhën Nëntor 2017-Nëntor2018 të vërtetuar me...” pasi nuk është paraqitur një marrëveshje/kontratë bashkimi ku të përcaktohet pjesëmarrja në përqindje dhe rrjedhimisht edhe numri mesatar i punonësve për periudhën e kërkuar për secilin operator ekonomik.
- Operatori ekonomik “Meteo” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë

13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për mjekun.

- Operatori ekonomik “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për mjekun.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/6 (gjashtë) punonjës hekurkthyes” pasi është paraqitur dokumentacion për vetëm 4 (katër) hekurkthyes, ku për 2(dy) prej tyre dëshmia e kualifikimit teknik është paraqitur e paplotë (pa përcaktuar vlefshmërinë e tyre).
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 15 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **ISO 50001 -2011 (e vlefshme)**. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.) pasi nuk është paraqitur një marrëveshje bashkëpunimi ku të përcaktohet se cili prej operatorëve e ekonomikë ka marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të punimeve dhe rrjedhimisht posedimin e Çertifikatës ISO 50001-2011.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B 93II” shpk & “Meteo” shpk & “Rafin Company” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)” pasi mjetet e deklaruar dhe paraqitura nga operatori ekonomik “rafin Company” shpk nuk plotësojnë tërësinë e makinerive të kërkuara ndërsa operatori ekonomik “B 93 II” shpk deklaroi nëpërmjet shtojcën 10 se mjetet dhe asetet fizike janë në dispozicion të një objekti tjetër jo të atij që prokurohet.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

- Shoqëria “Curri” shpk nuk disponon Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se disponon 4 (kater) kamionçina përkatësisht me targa AA 653 HA; AA 395 OS, AA 179 OL si dhe AA 244UC . Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 653 HA ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton; mjeti me targë AA 395 OS ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton, mjeti me targë AA 179 OL ka kapacitet mbajtës 1.3 Ton ndërsa mjeti me targë AA 244 UC ka kapacitet mbajtës 1 Ton . Për sa më lart, Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”*.
- Referuar Shtojcës 10, Shoqëria “Curri” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues konstatoi se mjeti i sipërcituar rezulton të jetë Autobitumatriçe e montuar = Kamion + cisternë termike, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”*.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

**5. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk
NUIS K11507003S & NUIS K17710805A**

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) kamionçinë me targa AA 841 KJ. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për disponimin e mjetit të sipërcituar, rezulton se kamionçina me targa AA 841 KJ ka kapacitet mbajtës 3.4 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton”*.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe me targa SH 5012 E. Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur, rezulton se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Akti i Pronësisë si dhe Çertifikata për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a” dhe gërma “b”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar disponimin e mjeteve Autobetoniere të deklaruar sipas Shtojcës 10, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17, gërma “a”.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dajti Park 2007” shpk & “Glavenica” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS K71412003A

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera.....”, pasi drejtuesi teknik i deklaruar për këtë procedurë prokurimi rezulton të jetë i anagazhuar gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës për procedurën e shpallur fitues me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 -5 ton*”, pasi kamioncinat me targë TR 3094 U, AA 057 N, AA 108 HK, VL 8838 C, Autobitumatrice me targë AA 782 FA dhe të gjithë kamionët e deklaruar në Shtojcën 10 rezultojnë të anagazhuar në procedurën e shpallur fitues me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Kthella” shpk**, me adresë: **Kompleksi “Kthella” Resort, Rruga “Shën Viçenzo De Paolo”, përballë varrezave të qytetit Rrëshen, Lezhë, Rrëshen**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **35,236,861** (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 28.01.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur një Formular Ankese hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 5602 Prot.

datë 04.02.2019. Me marrjen e ankesës në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 5602/1 Prot. dt. 04.02.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma "a" të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 5602/2 Prot. datë 04.02.2019 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Ankimuesit konkludoi në mospranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje nëpërmjet shkresës me Nr. 5602/4 Prot. , datë 08.02.2019.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga pala ankimuese pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mbështetje të Nenit 63, pika 6 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), nuk u paraqit asnjë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.